

03 Nr. Br. 400-27031
25-10 20 23
Dragash - Dragaš

KONTRATË

Date: 25.10.2023.

Numri i kontratës:¹ 621-23-10500-5-2-1/C824

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik Niki - GD SH.P.K.; NIKI 999 SH.P.K., Rruga e restelices, Dragash, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

•085•Kubëzimi i rrugeve, ndertimi i murit mbrojtës të varrezat dhe ndertimi i rrethojës të parku në fshatin Brod (RITENDERIM) me numër identifikues: 621-23-10500-5-2-1, dhe nr, te mbrendshem 621-2023-85-521.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: A - NDËRTIMIN E RRUGËS 1 1 - KUBËZIMI I RRUGËS - 325.50m² 2 - MURI MBROJTËS Hmin=0.7m dhe Hmax =2.5m L=42m 3 - DRENAZHIMI L=60m B - REKONSTRUKTIMI KUBËZAVE EKZISTUESE 1-RIKONSTRUKTIMI I KUBËZAVE A=500 m² F - PUNIMI I PLLATOVE TË OBJEKTIT ZYREVE, VENDIT DHE GARAZHDA 1 - KUBËZIMI I PLLATOVE ZYRA E VENDIT A=40m² 2 - dera e hyrjes H=1.5m L=1.5m 3 - SHKALLËT YE ZYRET E VENDIT - 1 copë I - PUNIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK • Furnizimi dhe instalimi i llambës të teknologjisë LED - 13 komplet •Furnizimi dhe montimi i kabllave vetëmbajtëse nga alumini me prerje tërthore-seksioni X00 2x16mm²-724.40m' •Furnizimi, transporti dhe vendosja e shtyllave-betonit i armiruar - 2 komplet,..... •si dhe elemente tjera të specifikuar në dosjen e tenderit

No.	Lot
1	•085•Kubëzimi i rrugeve, ndertimi i murit mbrojtës të varrezat dhe ndertimi i rrethojës të parku në fshatin Brod (RITENDERIM)

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **34,645.46 €**; (tridhjetë e kater mij e gjashtëqind e dyzet e pesë Euro e dyzet e gjashtë cent).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)

[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].


3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij. 4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye. 4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Nuro Ismaili
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	25.10.2023.
Vula:	

Për Kontraktuesin

Emri:	Grup i Operatorëve Ekonomik Niki - GD SH.P.K.; NIKI 999 SH.P.K., Rruga e restelices, Dragash
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	25.10.2023.
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 621-23-10500-5-2-1/C824

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguheshin ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Ne rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferoj menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materiale, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësura.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës së specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë së paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skemën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërrhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, ruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të barlet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

MATERIALET DHE MJESHTËRITË

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhënë Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bërë Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar të dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marrë një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet të referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë *"Menaxherin e Projektit"*, të cëkur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për të lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrëritë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo

prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere te nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përgjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do t'i paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhën nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të

pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jetë rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktajnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimi;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktojnë jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit. Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimit dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është : min 10 % e çmimit total të kontratës, nga një Bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, apo kompani e sigurimeve e licensuar nga BQK. Ose 3,464.54 € Afati i validitetit i Sigurimit të Ekzekutimit- 70 ditë, ose deri me date 02.01.2024.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Planin për Menaxhimin e Kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <u>2 ditëve</u> nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : Dy ditë pas nënshkrimit të kontratës, në konsultim me menaxherin e projektit)
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës 40 ditë kalendarike, ose deri me date 02.12.2023.
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.

Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahet nga ana e kontraktuesit
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni i Pranimit të punëve – shërbimeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve-shërbimeve të Autoritetit Kontraktues. Menagjer i projektit nga AK është: Xhylbehar Taipi Menagjer mbikqyres i kontrates nga AK është: Bean Haxhiasani Menagjer i projektit nga OE është: Nail Bahtijari
Pagesa		Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit deri në 70 % të projektit, pagesa do të kryhet në afate sa më të shkurtë kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimi dhe evidentimit të faturës, kurse pjesa tjetër e kontratës do të realizohet pas perfundimit të punimeve të percjellura me raport nga ana e menaxherit të kontrates dhe raportit nga ana e komisionit të pranimi teknik të projektit.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagesë paraprake.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: E vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimi teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti e lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vleren e pergjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimi teknik të përkohshëm.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me

gjqësore		ligjin në Kosovë. b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.
----------	--	---

KUBËZIMI I RRUÇËVE, NDËRTIMI I MURIT MBROJTËS TË VARREZAT, DHE RRETHOJES NË PARK NË FSHATINË BROS

NDËRTIMI I RRUÇES I					
KUBËZIMI I RRUÇES					
Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Evropiane dhe Eurokodit, Kompania punë kryese është përgjegjëse për të marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punuesit me njëjet sinjalizuese para fillimit të punës, nëqë të zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntokësore tëqytetarëve është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të veten financiare					
PUNËT PREGADITORE					
1					
1.1.1	Shërimi i kanterit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te infrastruktura rrugore sipas projektit detal gjatë kohës së zgjatit punimet .Llog në m2	m2	310.00	1.00 €	310.00 €
1.1.2	Identifikimi dhe dislokimi i instalimeve nëntokësore dhe mbetokësore (tuesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në dilarin ndertimor, me qëllim të evitimit paandalimit dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimt për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe përgaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe kubëzimin e kubëzave në rrugët lokale të fshatit. Llog m2	m2	310.00	1.00 €	310.00 €
1.1.3	Shërimi dhe inçizimet gjeodezike në zonat dhe segmentet rrugore ku do të punohet sipas projektit detal gjatë kohës së zgjatit punimet .Llog në m2	m2	310.00	1.00 €	310.00 €
				Gjithsej: Pos 1	930.00 €
2	PUNIMET TOKËSORE				
Germimi, gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V Me makina ndertimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashësi t = 20 deri ne 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terenit me ramjet e duhura duke përfshi edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe datave teknike . Largimi i dheut te gërmuar ne depozim te cilen e cakton investitori .Llog m3 me të gjitha shpenzimet.					
1.2.1	Germimi me makineri (70%)	m3	89.40	3.00 €	268.20 €
1.2.2	Germimi me dorë (20%)	m3	25.54	3.00 €	76.63 €
1.2.3	Germimi me çekan (10%)	m3	12.77	3.00 €	38.32 €
1.2.4	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugës , para se të vendosen shtrësat e tamponit .Llog me të gjitha shpenzimet	m2	310.00	0.50 €	155.00 €
				Gjithsej: Pos 2	548.15 €
3	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)				
1.3.1	Gjetelekstili me këto karakteristika: • Peshë minimale 300 gr/m2 • Forca e drejtimit gjatësor min 4kN/m • Forca e drejtimit tërthor min 7.5kN/m • Rezistenca CBR ndaj depërtimit më shumë se 1300N, e cila vendoset me mbivendosje 200mm. Furnizimi/bleja, transporti, vësjja në vepër, shtrësat niveluese, dhe të gjitha të tjerat që janë të nevojshme për të kryer në mënyrë kualitative të një pozicioni, janë gjithashtu pjesë e punëve të mbështetëseve dhe duhet të merren në llogari në çmimin njësi. /Sipas përshkrimit teknik.	m2	310.00	1.00 €	310.00 €
Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtrësës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror /faksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtrësës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=650 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet te jete i pastru me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve. Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrëse kompania punëkyese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontrates.					
1.3.2	Furnizimi dhe punimi i shtrësës rrugëve me gurë të thyer faksion 0-63 mm t=20cm	m3	65.10	13.00 €	846.30 €
Furnizimi, transporti, shtrirja,nivelizimi i bazës dhe punimi i bazës së rrugës , me materiali guror nga gurit të thyer faksionit (0-32) mm me trashësi të shtrësës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues.Materiali i përdorur duhet te jete i pastru me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Ngjeshja deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv= 500 kg/cm2 . Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrëse kompania punëkyese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontrates.					
1.3.3	Furnizimi dhe punimi i shtrësës rrugëve me gurë të thyer faksion 0-31.5 mm , t= 10 cm	m3	32.55	14.00 €	455.70 €

Furnizimi, transporti, shtrija dhe punimi i shtresës rrafshuese me rreze të mëdha nga gurët të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës 100 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes $M_v=500 \text{ kg/cm}^2$. Sqarim: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqiptoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezantoj tek menaxheri kontrates.

1.3.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-4 mm $t=5 \text{ cm}$	m ³	16.28	14.00 €	227.85 €
Gjithsej: Pos 3					1,839.55 €

4 PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE

Furnizimi, transporti dhe montimi i elementeve nga betoni, llogaritur të gjitha punimet e nevojshme, nga betoni i klasit C 30/37, d-8cm forma e gjeometris se kubezave, kompetenc e përcaktuar nga investitori. Në çmim të parashitet edhe Furnizimi, transporti dhe shpenzimet e reres (filerit) për mbushjen e fugeve në sipërfaqen e cila është e kubezuara. Vërejtje: Ruga e cila kubëzohet në tërësi të sipërfaqes zgjeruese prej muri në murë kur nuk ka gurë skajor përforcimi i kubezave bëhet me beton në tërë gjatësin e rrugës të shprehur në m2 në dy anët e rrugës për gjatë perimetrit të rrugës.

1.4.1	Furnizimi, Transporti dhe montimi i kubezave duke llogaritur në çmim edhe mbushjen e fugeve me rërë (filer)	m ²	375.50	11.00 €	3,550.50 €
1.4.2	Furnizimi dhe montimi i skajoreve nga betoni C 30/37 dim (15x25x80) cm, me baze betoni llogaritur me të gjitha punimet e tjera të nevojshme.	m'	10.00	8.00 €	80.00 €
1.4.3	Furnizimi, transporti, punimi dhe nivelizimi i kokave të pusetave me shtresën finale të kubezave, koka përforcohen me beton arme, inkastronhet meaza metalike, si dhe vendosja e kapakut nga giza 60T i qëndrueshme ndaj komunkacioneve të rënda. Çmimi kalkulohet në m' të rrugëve të kubëzuara, Vërejtje: Ky pozicion aplikohet kur paraqitet nevoja e ngritjes së pusetave ekzistuese në rrugë për implementim të projektit, për shkak se pusetat po janë mbuluara me zhavorr apo kubëza.	Copë	4.0	130.00 €	720.00 €
Gjithsej: Pos 4					4,180.50 €

I. REKAPITULIMI - KUBËZIMI RRUGËS I:

1.1	PUNËT PREGADITORE	Gjithsej: Pos 1	930.00 €
1.2	PUNIMET TOKËSORE	Gjithsej: Pos 2	538.16 €
1.3	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)	Gjithsej: Pos 3	1,839.85 €
1.4	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE	Gjithsej: Pos 4	4,180.50 €
TOTALI ME TVSH			7,488.51 €

II MURI MBROJTËS Hmin=0.7m dhe Hmax =2.5m L=42m					
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
2	MURI L=42m; limes=1.30m				
2.1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKTE NË TEREN				
2.1.1	Incizimi i terenit si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit	m'	42.00	1.50 €	63.00 €
2.2	PUNËT TOKËSORE		Gjithsej 1.1:		63.00 €

2.2.1	Pastimi i terrenit si dhe prerja e drunjeve , preja dhe demolimi i mureve ekzistuese betonarme ne tere gjatesin e trases ku do te ndertohet muri mbrojtës. Në qmim kalkulohet edhe hartja e materialit të demohuar beton armë deri të deponia inerte , llog m'	m'	12.00	3.00 €	126.00 €
2.2.3	Gërmimi dheut (themeleve) i kategorisë së II- III-të si dhe transporti i materialit te gërmuar ne depuni deri ne 15 km.	m³	60.00	3.00 €	180.00 €
2.2.4	Formësimi dhe ngjeshja e nenbazeve se themeelit te murit me ngjeshmeri 30MN/m2	m²	60.00	3.00 €	180.00 €
2.2.5	Sigurimi i gropës ndërtimore nga rrëshqitja e dheut si dhe vendosja e shenjave të sigurisë konform normave ndërtimore në fuqi	m'	12.00	3.00 €	126.00 €
			Gjithsej 1.2:		612.00 €
2.3 PUNËT E MBUSHJES					
2.3.1	Furnizimi,shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Ø 63mm nen bazen e themeelit me trashësi t=35cm me ngjeshmeri 50MN/m²	m³	20.00	14.00 €	280.00 €
2.3.2	Furnizimi dhe mbushja mbirapa murit me zhavorr te pastër te lunit 63 mm ne tere lartesine e murit me b=50 cm	m³	20.00	14.00 €	280.00 €
2.3.3	Furnizimi dhe montimi i gypit te drezhit PVC Ø100 mm prapa murit	m	42.00	2.00 €	84.00 €
2.3.4	Gyp PVC Ø 70 mm për kullim në murin e betonit në çdo 2.0 m ,zig zak.	m'	42.00	2.50 €	105.00 €
2.3.5	Armaturimi me meshpa me qerpi me trashësi 30mm ne tere lartesine e murit me gjerësi jo me te medhenje se 150mm, ne tere lartesine e murit me trashësi t=30mm	m³	30.00	5.00 €	150.00 €
			Gjithsej 1.3:		899.00 €
2.4 PUNËT E BETONIT					
2.4.1	Furnizimi,transporti dhe betonimi i themeleve te murit mbrojtës nga betoni i thjeshtë C12/15 me trashësi 5 cm, ne çmim te llogaritët vendosja e pahive dhe mirmbajtja e betonit. Sipas detalit te dhënë, llog ne m2	m³	3.00	65.00 €	195.00 €
2.4.2	Furnizimi,transporti dhe betonimi i themeleve te murit mbrojtës nga betoni i armuar C25/30 me additive papërshkueshëm nga uji ne thellesi h=0.7m dhe gjerësi b=1.50m, ne çmim te llogaritët vendosja e pahive,fugat e dilalimit ne çdo 6.0 m, dhe mirmbajtja e betonit. Sipas detalit te dhënë,	m³	20.13	100.00 €	2,013.00 €
2.4.3	Furnizimi,transporti dhe betonimi i murit mbrojtës me lartesi hmes=4.00m dhe trashësi te ndryshuar nga betoni i armuar C30/37 me additive papërshkueshëm nga uji.Ne çmim te llogaritët vendosja e pahive,fugat e dilalimit çdo 6 m. Sipas detalit te dhënë.	m³	14.60	100.00 €	1,460.00 €
			Gjithsej 1.4:		3,668.00 €
2.5 PUNËT E ARMATURËS					
2.5.1	Furnizimi,transporti,lakimi dhe montimi i armatures se brinjezuar S-400/500 per themele dhe murin mbrojtës. Sipas detalit te dhënë.	kg	5,000.00	1.00 €	5,000.00 €
			Gjithsej 1.5:		5,000.00 €

REKAPITULLIMI I MURIT NE RRUGËN 1		
2	MURI L=42m ; Hmax=1.30 m	
2.1	INÇIZIME TË DHE PUNËT PARAPRAKË NË TEREN	63.00 €
2.2	PUNËT TOKËSORE	612.00 €
2.3	PUNËT E MBUSHJES	899.00 €
2.4	PUNËT E BETONIT	3,668.00 €
2.5	PUNËT E ARMATURËS	5,000.00 €
Totali me TVSH		10,242.00 €

DRENAZHIMI L=60m					
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
3.1	Blerja, transportimi dhe montimi i gypit të drenazhimit HDPE PSN3 me rrima Ø225 mm për largimin e ujitave nëntokësore. Në qmim të kalkulohet hapja e kanalit me dim 0.5x1.5 m dhe materiali drenazhues rreth dhe mbi gyp. Në qmim të kalkulohet edhe zhavorri (1 laut) për mbushjen e kanalit. 1.1og m'	m'	60.00	30.00 €	1,800.00 €
Gjithsej 3.1:					1,800.00 €

REKAPITULLIMI I RRUGËS 1		
1	KUBËZIMI I RRUGËS	7,488.51 €
2	MURI MBROJTËS Hmin=0.7m dhe Hmax=2.5m L=42m	10,242.00 €
3	DRENAZHIMI L=60m	1,800.00 €
TOTALI ME TVSH		19,530.51 €

REKONSTRUKTIMI KUBËZAVE EKZISTUESE					
RIKONSTRUKTIMI I KUBËZAVE A=500 m2					
1.1.1	Demolimi i kubëzave dhe skajorëve ekzistues të rruga e cila do të rikonstruktohet, materiali i demoluar largohet me ngarkim dhe transport deri në deponim më të afërt deri në 10 km largësi	m2	400.00	5.00 €	2,000.00 €

1.1.3	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>80MN/m² prej gurit të thyer të fraksionuar sipas Standardit AASHTO-27 me fraksion: 0-63mm me trashësi ≤ 30cm si bazë për vendosjen bitu zhavorit në rrugë.	m3	130.00	12.00 €	1,560.00 €
1.1.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>110MN/m² prej gurit të thyer të fraksionuar sipas Standardit AASHTO-27 me fraksion: 0-31.5mm me trashësi ≤ 10cm si bazë për vendosjen e asfalt betonit.	m3	50.00	14.00 €	700.00 €
1.1.5	Blerja, furnizimi dhe vendosja e kubëzave të betonit me trashësi	m2	400	11.00 €	4,400.00 €
1.1.6	Furnizimin dhe vendosja e skajorëve nga Betoni C25/30 dim 18x24 cm, dhe materialeve tjera të ngjura. 1.1og me m'	m'	10	8.00 €	80.00 €
Rekapitullimi Rikonstruktimi I rrugëz Ekzistuese:					8,740.00 €

PUNIMI I PILLATOVE TË OBJEKTIT ZYREVE VENDIT					
KUBËZIMI I PILLATOVE ZYREVE VENDIT A=40m2					
1.1.1	Pastrimi i terrenit si dhe prerja e drunjeve, prerja dhe demolimi i murëve ekzistues betonarme në tërësi gjatësin e trases ku do të ndërtohet muri mbrojtës. Në qmim të kalkulohet edhe bartja e materialit të demoluar beton armë deri në deponia inerte. 1.1og m2	m2	40.00	2.00 €	80.00 €


1.1.2	Gërmimi i dheut deri h=30 cm i kategorisë së II- VI-të si dhe transporti i materialit të gërmuar në depони deri në 15 km.	m³	12.00	1.00 €	18.00 €
1.1.3	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Me>80MN/m² prej gurit të thyer të fraksionuar sipas Standardit AASHTO-27 me fraksion: 0-63mm me trashësi t=30cm si bazë për vendosjen bitumavorit në rrugë.	m3	12.00	14.00 €	168.00 €
1.1.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Me>110MN/m² prej gurit të thyer të fraksionuar sipas Standardit AASHTO-27 me fraksion: 0-31.5mm me trashësi t=10cm si bazë për vendosjen e asfalt betonit.	m3	4.00	14.00 €	56.00 €
1.1.5	Blerja furnizimi dhe Vendosja e kubëzave të betonit me trashësi t=5cm kualiteti i kërkuar sipas EN1340:2003, soliditeti në lakim, min klasa-2/T, dhe kriteret tjerë ngjirje shkrije-krypëra, abrazion. Në këtë pozicion të përshkruhen shtresat e tamponit 0-4mm , t=5cm forma e tyre përzgjedhet nga investitori. Klasa e betonit - C25/30. 1.1log m2 me të gjitha shpenzime.	m2	40	11.00 €	440.00 €
1.1.6	Demolimi dhe largimi i pllakave të vjetra dhe Furnizimi dhe montimi i pllakave teraco të reja të cilën e cakton investitori hyrjen e A/A3/3, të vendosura në ngjites special të jashtme.	m²	6.525	20.00 €	130.50 €
			Gjithsej 1.1		922.50 €
II	Dera e hyrjes në hyrje të objektit me dimension II=1.5m L=1.5m				
	Deres për ndarjen e Oborrit të zyrës e vendit , cikli të garazhada me lartësi H=0.5m				
1.2.1	Furnizimi,transporti dhe montimi i derës për oborr nga metali me ram metalik drejete kundesh (40x40)mm me dim.(1.5x 1.5)m si dhe ndarjet në mes të kornizës të jenë nga profilet metalike (40x20)mm,trashësia e mureve të profileve duhet të jetë 2mm të ngjyrosura të zeze metalike.Dera duhet të montohet në mes të shtyllave nga betoni.	m²	2.25	95.00 €	213.75 €
			Gjithsej 1.2		213.75 €
III	SHKALLËT YË ZYRËT E VENDIT				
1.2.1	Furnizimi, transporti dhe betonimi i shkallët të zyrës e vendit , gjithsej tri shkallë me dimensione 1.5x1.20m. Punimi të bëhet nga betonit i armuar me armaturë sipas planit të armimit dhe llogaritjes statike. Klasa e betonit është C25/30 dhe duhet të përmbajë aditiv në jo ujepërkueshmëri. Në llogaritje të merret edhe peshja e nevojshme. Të merret mostra dhe përveç testimit në shtypje të bëhet edhe testimi në ujepërkueshmëri. Në çmim kalkulohet të gjitha punët tokore dhe zhavorrike si dhe betoni i varfër 5cm, llog për komplet të finalizimit të këtij pozicioni	komplet	1	700.00 €	700.00 €
			Gjithsej 1.2		700.00 €
REKAPITULLIMI TOTAL I PUNIMIT PËLLATOVE DHE DERY DHE SHKALLË					
1	KUBËZIMI I PËLLATOVE ZYRËT E VENDIT A=40m2				922.50 €
2	Dera e hyrjes në hyrje të objektit me dimension II=1.5m L=1.5m				213.75 €
3	SHKALLËT YË ZYRËT E VENDIT				700.00 €
	TOTALI ME TVSH				1,836.25 €
I	PUNIMI I NDRICIMIT PUBLIK				
	Poqë ndriçues, E10 - 30W				
	Furnizimi dhe instalimi i llambës të teknologjisë LED. Llamba				
	• Mbrojtje mekanike; IP65 (IP66)				
	• Qëndrueshmëri pune: 100 000 (h/pune) të deshumar me TEST RESUIT				
	• Efikasiteti të ndriçueshmërisë: 170 lm/W ~ 8500lm				
	• Temperaturë të ngjyrës: 5000K				

1.1.1	• Tension pune: 90...305 V (50 Hz) • Faktor të fuqisë: > 0.97 • Temperaturë pune: (-10 ... +80)°C Mbrojtje në goditje: IK08 • Garancioni: ≥ 5 vite. Lamba duhet të jetë nga Alumini i derdhur, Optikat (LJNS) duhet të jenë të vendosura sipas dizajnit të rruges dhe të jenë të deshmuar me Software Dial.UX. (Detali i shtyllës dhe trupit ndriqes është në përshkrim Teknik)	komplet	13	80.00 €	1,040.00 €	✓
1.4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i relesë Astrologjike IC Astro Siemens, Schneider, ABB ose e ngjashme	komplet	1	35.00 €	35.00 €	✓
1.4.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit ndriqes me dizajn të ngjashëm me ato egzistuese për vendosjen e paqil lled pa trafo	komplet	13	15.00 €	195.00 €	✓
1.4.3	Furnizimi dhe montimi i shtërngueses rrymore izoluese (FIDOS) 16-35	komplet	1	8.00 €	8.00 €	✓
1.4.4	Furnizimi dhe montimi i kutis OG 250x300mm IP 65 për vendosje të elementeve për kyçe	komplet	1	8.00 €	8.00 €	✓
1.4.5	Furnizimi dhe montimi i shirit 1m për vendosje të siguresave elektrike	komplet	1	8.00 €	8.00 €	✓
1.4.6	Furnizimi dhe montimi i sigureses automatike njëpolare me karakteristike të veprimit B, 10A, 6kA	komplet	13	3.50 €	45.50 €	✓
1.4.7	Furnizimi dhe montimi i klemave për përforcim në shinë për vendosje të kabllave prej 1.5-35 mm ²	komplet	13	4.00 €	52.00 €	✓
1.4.8	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e kabllos nëntokësore i TIP-II PT00 2x25mm ² Al për furnizim nga (KSH-1) deri në shtyllën e parë të betonit.	m'	15	6.00 €	90.00 €	✓
1.4.9	Furnizimi, transporti dhe lidhja e Papugeve (Al Cu) 25 mm ²	komplet	1	3.00 €	3.00 €	✓
1.4.10	Furnizimi dhe montimi i kabllave vetëmbajtëse nga alumini me	m'	724.4	3.50 €	2,535.40 €	✓
1.4.11	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shtyllave të tensionit të I lartësi dhe themelit të shtyllës dhe largimi i dheut deri në deponi: Fortësia e tokës "d" daN/cm ² -1.5, Konstanta "C" daN/cm ³ -5.0(A-1.00xB-1.00xt-1.80)	komplet	2	180.00 €	360.00 €	✓
1.4.12	Furnizimi dhe montimi i sondës kryqëzore e zinguar Fe/Zn për përforcimin e tokëzimit	m ³	3.6	8.00 €	28.80 €	✓
1.4.13	Furnizimi me beton të klases C20/25 si dhe betonimi i themelit dhe gypit betonit me të cilin përforcohet shtylla elektrike Fortësia e tokës "d" daN/cm ² -1.5, Konstanta "C" daN/cm ³ -5.0(A-1.00xB-1.00xt-1.60)	cop	2	50.00 €	100.00 €	✓
1.4.14	Furnizimi dhe montimi i sondës kryqëzore e zinguar Fe/Zn për përforcimin e tokëzimit	komplet	2	7.00 €	14.00 €	✓
1.4.15	Furnizimi dhe montimi i mazës mbërthyes me vegë nga çeliku për varje dhe tërheqje të kabllit ABC shtylla këndore me diametër 250-300mm	komplet	2	8.00 €	16.00 €	✓
Totali me TVSH:					4,538.70	✓

REKAPITULLIMI TOTAL I INFRASTRUKTURËS NË BROD		
A	NDËRTIMET RRUGËS I	19,530.51 €
B	REKONSTRUKTIMI KUBIZAVE EKZISTUESE	8,740.00 €
F	PUNIMJI PËLATOVE TË OBJEKTIT ZYRËVE VENDORIT	1,536.25 €
I	PUNIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK	4,538.70 €
TOTALI ME TVSH		34,345.46 €



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



- Kryetari i Komunës
01 Nr. 140/01 - 29379/23
Dt. 24.10.2023
Dragash

Kryetari i Komunes, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik/Nr. A01, nxjerr:

V E N D I M

Caktohet menaxheri i kontrates dhe mbikqyesi në realizimin e kontrates •085• Kubëzimi i rrugëve, ndertimi i murit mbrojtës të varrezat dhe ndertimi i rrethojës të parku në fshatin Brod (RITENDERIM) me numër identifikues: 621-23-10500-5-2-1, dhe nr. të mbrendshëm 621-2023-85-521.

Xhylbehar Taipi - caktohet menagjer i kontrates,


Bean Haxhiasani - Mbikqyes i drejteperdrejt i menagjerit të kontrates

Menaxheri i kontrates, obligohet që të hartojë një plan të menaxhimit të Kontrates, duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e të dy paleve (Menaxherit të Kontrates së AK dhe Menagjerit të Kontrates së OP) para inicimit të zbatimit të kontrates dhe një kopje të nënshkruar të planit për menaxhimin e kontrates do ta përcjellë tek departamenti i prokurimit.

1. Menagjeri i kontrates e menagjon kontraten deri në pranimin e plotë të punëve të kërkuara-kontraktuara, respektivisht deri në përfundimin e kontrates.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Kryetari i Komunes:
Bexhet Xheladini

Vendimi u dërgohet: menagjerit të projektit,
Mbikqyesit të kontrates,
Zyres së Prokurimit,
Drejtorit të Drejtorisë përkatëse,
Arkivit të Komunes (kryetarit).



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 118959

Për KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të NIKI - GD SH.P.K. & NIKI 999 SH.P.K.

(emri dhe adresa e "Operatorit Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Kubëzimi i rrugëve, ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat dhe ndërtimi i rrethojës të parku në fshatin Brod (RITENDERIM).**

Nr. prokurimit: 621-23-10500-5-2-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke ju referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'ju japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **3,464.54€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka deshtuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka deshtuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetur pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.


Pagesa në shumën e limituar prej **3,464.54€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vërtetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 70 ditë kalendarike prej **24.10.2023** deri më **02.01.2024**.

Data feshimit: 24.10.2023

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

Ky garancion i nënshkrohet tregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a., Prishtinë, Adresa Rr "Tringë Ismajli"-nr.19,
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com

Gjithcka që duhet ta keni



POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: 118959

Kontraktuesi

Emri: NIKI - GD SH.P.K. & NIKI 999 SH.P.K.
Përfaqësuar nga: Lirim Sadikaj
Adresa: Restellicës
Nr i Biznesit: 810085755
Telefoni: 029811361

Përfituesi

Emri: KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI
Adresa: DRAGASH

Garantuesi

Emri: Elsig
Banka: NLB
Garantuesit:

Mbulueshmëria e Polices

Shuma Siguruar: 3,464.54
Periudha Sigurimit: 24.10.2023 - 02.01.2024
Primi: 62.36
Tesh: 11.23
Primi Bruto: 73.59
Data e lëshimit: 24.10.2023 13:20

Aktiviteti Ekonomik:

Kubëzimi i rrugëve, ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat dhe ndërtimi i rrethojës të parku në fshatin Brod (RITENDERIM).


Lënda e Garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:


- Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merret përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontrates.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
- Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përberëse e kësaj Police.
- Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përberëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërtimjet autontetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marreveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng).

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit të ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium, I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig
Bojram Fazliu - 1940



Përfaqësuesi i të Siguruarit
Lirim Sadikaj